

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 31 MARS 2022

Po jap unë disa përgjigje, zoti Vasili. Së pari, në raport me taksën e qarkullimit dhe të karbonit, një taksë e vendosur në kohën e Partisë Demokratike, kjo është një taksë e vendosur drejt me parimin se kush ndot më shumë, paguan më shumë. Sigurisht, duke qenë një politikë e drejtë, u mbajt edhe nga qeveria “Rama”, pasi edhe filozofia se kush fiton më shumë, paguan më shumë, shkon në linjë me këtë postulat. Vendet e tjera të rajonit, që ju i përmendët në diskutimin tuaj, i kanë këto taksa, por i kanë në formate të tjera, madje janë më të larta se sa në Shqipëri. Por gjykimi se kush ndot më shumë dhe kush përdor më shumë karburant paguan më shumë, është një gjykim i drejtë, këtu nuk besoj se do të ketë ndonjëri kundërshtim me këtë format të diskutimit dhe nuk mund të hiqet, është një taksë për ndotjen e ambientit. Ju diskutuat edhe për disa taksa, por sigurisht unë nuk dua që fjalën time ta mbaj vetëm për taksat, prandaj e devijova pak fjalimin.

Më lejoni të them disa krahasime në raport me vendet e rajonit, po marr vetëm Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, pasi nuk mund të krahasosh vetëm një element, por të gjithë regjimin fiskal dhe më tej. Kontributet e sigurimeve shoqërore në Shqipëri në total shkojnë 27,9%, sepse po flasim për të ardhura, ndërsa në Maqedoninë e Veriut janë 42,5% dhe në Serbi 47,5%. Për këtë nuk flisni. Të flasim për TVSH-në. Për biznesin e vogël TVSH-ja sot është zero, pra për 93 mijë biznese, që janë pjesa dërrmuese e numrit total në këtë strukturë të organizimit të bizneseve, ndërsa në Maqedoninë e Veriut është 18% dhe 20% në Serbi. Tatimfitimi, me ndryshimet që bëmë në vitin 2020 në këtë parlament të nderuar, është zero për biznesin e vogël, ndërsa në Maqedoninë e Veriut është 10% dhe 15% në Serbi. Për t’i kthyer përgjigje edhe kolegut Dule, i cili vuri në dyshim atë diskutim që u bë edhe nga ministrja, por edhe nga shumë kolegë të tjerë deputetë të maxhorancës, që reduktimi i taksave dhe i TVSH-së në veçanti në rastin e Shqipërisë nuk ka rezultuar të ketë çuar në reduktimin e çmimeve. Kjo është e provuar në shumë vite.

Unë gjykoj se regjimi fiskal në Shqipëri nuk mund të preket në një situatë krize, në një situatë emergjente. Ne kemi punuar dhe po punohet për një strategji afatmesme të të ardhurave, ku çdo koleg deputetë i opozitës dhe i pozitës të ketë mundësi të kontribuojë dhe të japë elemente të vlefshme strukturore për këtë strategji afatmesme të të ardhurave. Por të mendosh që në një situatë krize të ndërpresësh të ardhurat, është e gabuar. Çfarë ka funksionuar? Në fakt, ka funksionuar vetëm ndihma e drejtpërdrejtë. Sot INSTAT-i ka nxjerrë shifrat, ku ka konfirmuar rritjen ekonomike për vitin 2021 me 8,54%, ka nxjerrë shifrën e 3-mujorit të katërt të vitit 2021 në krahasim me një vit me parë me 5,5%. Sigurisht, kjo rritje ekonomike e vitit të kaluar ishte falë punës së bizneseve, të të punësuarve, të cilët në fund të vitit ishin edhe më shumë se përpara krizës, por dhe të qeverisë, sepse reagimet me disa akte normative, për të cilat jemi kritikuar sikur e kemi bërë shpesh, në ndihmë të paketave dhe të qytetarëve të biznesit, sollën ndihmë në këtë rritje ekonomike.

Në këtë frymë është edhe ky akt normativ. Mund të jetë i pari dhe jo i fundit, pasi kjo është situatë dinamike dhe mund të përshkallëzohet, sepse asnjëri nuk e parashikon se kur do të ndërpritet. Por e

është padiskutueshme fryma me të cilën vjen paketa, e cila është në linjë me ato që përballuan dy krizat e mëparshme, me efektivitetin e masave, ku ndihma e drejtpërdrejtë ishte e duhura. Sot ne po flasim për ndihmë të drejtpërdrejtë, për ata që kanë më shumë nevojë. A do të ketë grupe të tjera që do të kenë më shumë nevojë? Sigurisht që po. Pra, ky duhet të ishte debati në këtë foltore dhe jo taksa dhe aq më tepër kritikën e vazhdueshme për masa në ndihmë të tyre. Nuk dua të shkoj në detaje të këtij akti normativ, pasi të gjithë e kemi lexuar, por shpesh diskutohet përse nuk reduktohen shpenzimet.

Në këtë akt normativ kemi reduktim shpenzimesh, sepse Ministria e Financave asnjëherë, kur sjell akte normative, nuk mendon që të mos reduktojë shpenzime, të cilat gjykohen në momente të vështira krizash, si kjo, të jenë të pacenueshme, duke filluar nga shpenzimet e personelit dhe shpenzimet operative, të cilat në total janë minus 5,8 miliardë lekë. Për të vazhduar me shpenzimet kapitale, 5,2 miliardë lekë janë ato me kapital të brendshëm dhe 4,6 miliardë lekë ato me financim të huaj. Këto nuk i tha njeri nga deputetët e opozitës, por u kërkua pikërisht kjo gjë, çfarë është bërë fakt. Sigurisht, është e diskutueshme nëse ka nevojë për më tej, ne e thamë që ky është vetëm fillimi, se nuk e dimë se si do të shkojë dhe se si do të vijojë, në këtë parlament do të jemi, urojmë që jo, por nëse është e nevojshme për të shkurtuar më tej dhe për të hyrë më tej, qeveria "Rama" e ka bërë në vitet 2020 – 2021, jam e bindur që do ta bëjë edhe këtë vit.

Është shumë e rëndësishme ta vendosim theksin aty ku duhet, te nevojat për individët dhe për bizneset dhe të sjellim në vëmendjen e tyre të gjithë paketën e ndihmës, asaj që sot quhet "Paketa e rezistencës", përtej çdo postulati që u bë këtu ironik, për t'u ardhur në ndihmë të tyre, nëse ka nevojë për më shumë, duhet ta sjellim në këtë parlament dhe ta vendosim qeverinë përpara detyrimit që të bëjë më shumë nëse është e nevojshme. Por të paktën të jemi mirënjohës për atë punë që është bërë deri tani, e cila ka nevojë për përmirësime në mënyrën se si mund të përshkallëzohet kriza. Një gjë është e sigurt: efektiviteti i masave është fakt dhe rritja ekonomike e vitit të kaluar këtë e ka vërtetuar. Sot doli raporti i INSTAT-it dhe mund t'i bëjmë referencë. Faleminderit!